



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. .... Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më \_\_\_/ 08 / 2021

**VENDIM**  
Nr.31, date 30 /08/2021

**PËR**

**ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE PER PROMOVIMIN DHE SENSIBILIZIMIN E  
VLERAVE TE SHUMANSHME TE DIGAVE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e datës 30.08.2021 mori në shqyrtim propozimin për organizimin e Aktiviteteve të Promovimit dhe Sensibilizimit të vlerave të shumanshme të digave.

Pas shqyrtimit të propozimit në fjale dhe diskutimeve nga të gjithë antaret pjesëmarrës, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha,

**VENDOSI:**

- 1- Të Miratojë Organizimin e aktiviteteve perkatese për promovimin dhe sensibilizimin e vlerave të shumanshme të digave të mëdha që përdoren për prodhim hidroenergjie në vendin tone.
- 2- Keto Aktivitete do të konsistojnë në përgatitjen e paketave fotografike profesionale dhe në organizimin e një konkursi për fotografime me të mirë profesionale dhe fotografime me të pelqyer nga publiku për të gjitha digat e mëdha që përdoren për prodhim hidroenergjie sipas listës bashkelidhur këtij vendimi.
- 3- Keto Aktivitete do të organizohen brenda muajit nëndor 2021 në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin Politeknik të Tiranës si dhe me shfrytëzuesit e këtyre digave.
- 4- Të gjitha paketat fotografike që do të dorëzohen pranë SKDM do të jenë pjesë e arshives teknike të KKDM dhe do të përdoren për promovimin dhe sensibilizimin e vlerave të digave.

Ngarkohet Kryetari i KKDM dhe Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**